

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

Albanian Digital Natives

Sot, më datë 02.11.2022, personalisht:

- **Kristi PULERI**, i biri i Kristaqit-it, i datëlindjes 08.12.1999, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Selitë, Tiranë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, me cilësinë e ortakut të shoqërisë tregtare Albanian Digital Natives Sh.p.k.

Përpilon këtë akt themelimi të shoqërisë tregtare **ALBANIAN DIGITAL NATIVES sh.p.k.**, me termat e mëposhtme:

NENI 1

Të themelojë Shoqërinë Tregtare **ALBANIAN DIGITAL NATIVES SH.P.K.**, në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria kundrejtuar të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri **ALBANIAN DIGITAL NATIVES SH.P.K.**, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe në Statut.

NENI 2 Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fusha të ndryshme. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë thellësisht me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

NENI 3 Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin e subjektit **ALBANIAN DIGITAL NATIVES SH.P.K** dhe me emrin tregtar **A.D.N Ajo** do të ketë edhe vulën e saj.

NENI 4 Objekti i veprimtarisë

Veprimtaria e shoqërisë do të jetë:

Mirëmbajtja dhe menaxhimi i rrjeteve sociale dhe kërkime të informacionit online për llogari të të tretëve. Krijim, implementim dhe mirëmbajtje faqe internet. Aktiviteti në fushën e shërbimeve informatike, krijim dhe shitje të programeve informatike (software). Projekte digjitale me programe informatike ku përfshihen por pa u limituar në programe arkitekurore.

NENI 5 Selia e Shoqërisë dhe Afati

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga e Kavajës, mbi OTP Bank, kati 2, pass.Nr.8/515+1-7, Tiranë.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një periudhë kohore pa afat.



NENI 6 Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar është 100.000 (njëqind mijë) Lek dhe zotërohet nga ortaku themelues.

Vlera totale e kapitalit të regjistruar: 100.000 leke

Vlera e paguar: 100.000 leke

Numri total i kuotave: 1.

Kapitali themeltar është mbuluar tërësisht nga ortaku i vetem themelues.

NENI 7

Ortaku i vetem themelues i Shoqërisë Tregtare ALBANIAN DIGITAL NATIVES Sh.p.k zotëron kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

- **Kristi PULERI**: pjesëmarrja në përqindje 100 %, 1 kuotë, lloji i kontributit para, 100.000 (njëqind mijë) Leke, kontribut i cili është paguar plotësisht dhe menjëherë.

NENI 8 Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Ortaku i Vetem – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

NENI 9 Administratori

Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit i cili zgjidhet për një mandat 4 (kater) vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Administratori i parë i shoqërisë do të jetë **Z. Kristi Kristaq PULERI**.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, entit publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 10

Ortaku mund të vendosë me vullnetin e tij, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 11

Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre.

NENI 12

Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

NENI 13



Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortaku Themelues u gjet sipas vullnetit të tij dhe u nënshkrua pa vërejtje. Akti i Themelimi hartohet në gjuhën shqipe.

ORTAKU I VETEM THEMELUES

Kristi PULERI

Kristi Puleri 